



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 41 date 27/04/2001

MBI

VENDOSJEN E TAKSES SE PERKOHSHME TE PARKUT KOMBETAR

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” Ligjit Nr.8453 dt.28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” neni 4, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë vendosjen e një takse të përkohshme për të gjithë subjektet sipas listës bashkëngjitur, e cila do të emërtohet “Taksa e Parkut Kombëtar” me objekt Bar-Restorant-Hoteleri.
2. Kjo taksë e përcaktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi do të jetë në masën 200 lekë për m² në muaj për sipërfaqen e objektit dhe 100 lekë për m² në muaj për sipërfaqen e truallit
3. Mbi bazën e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ndërmarrja e Tregjeve dhe Taksave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA